

FAKULTETI I DREJTËSISË**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË E DREJTË BIZNESI
60 ECTS****KREU I
PARIMET E PËRGJITHSHME****Neni 1
Baza ligjore**

Rregullorja mësimore e programit të studimit Master Profesional në e Drejtë Biznesi mbështetet në Ligjin Nr. 80, 22. 07. 2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 Strategjinë e Zhvillimit të TBU-së, Statutin dhe Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

**Neni 2
Objekti**

Kjo rregullore përcakton organizimin e programit të studimit Master Profesional në E Drejtë Biznesi. Ajo është hartuar në përputhje me planin mësimor të programit, duke respektuar legjislacionin në fuqi, lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Çdo aspekt tjetër që nuk është trajtuar në këtë rregullore do të trajtohet ashtu si përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme dhe Statutin e TBU-së.

**KREU II
ELEMENTËT E PROGRAMIT MËSIMOR****Neni 3
Qëllimi dhe objektivat**

Qëllimi i këtij programi është të përgatisë profesionistë të aftë që të operojnë në fushën e Të Drejtës së Biznesit me njohuri të plotësuar në fushën ekonomike, të cilët janë të formuar rigorozisht dhe të pajisur mirë me të gjitha aftësitë praktike për të analizuar dhe zgjidhur çështje komplekse të kompanive të ndryshme nga perspektiva e të drejtës së biznesit. .

Objektivat e programit janë:

- Të përgatisë studentë me njohuri të specializuara mbi legjislacionin që ndikon më shumë në veprimtarinë e biznesit dhe ti bëjë të aftë për të vendosur lidhje ndërdisiplinore.
- Të përgatisë studentë që të jenë të aftë që zgjidhin çështje gjyqësore që ka të bëjnë me veprimtarinë e sipërmarrjeve dhe probleme ekonomike.
- Të përgatisë studentë që të jenë të aftë që të mbledhin, përzgjedhin, vlerësojnë dhe interpretojnë informatat relevante për zgjidhjen e një problemi në mënyrë që të arrijë në një vlerësim kompetent të parë nga këndvështrimi juridik, ekonomik dhe ai i korporatave.

- Të përgatisë studentë me njohuri shumë të specializuara, disa prej të cilave në nivel të avancuar bashkëkohor në një fushë pune, si bazë për mendim dhe kërkim origjinal. Analizë kritike e dijeve në një fushë ose në ndërveprimin në fushën e te drejtes së biznesit.
- Të përgatisë studentë që të jenë të aftë për të paraqitur problemet gjyqësore në mënyrë të përmbledhur me shkrim dhe me gojë.
- Të përgatisë studentë që të kenë aftësi për të përpiluar akte ligjore që lidhen me fushën e biznesit, kontratave, kërkesave drejtuar organeve administrative dhe gjyqësore, etj.
- Objektivi kryesor i TBU është aftësimi dhe punësimi i studentëve në zyra ligjore ose si asistent ligjor perpara perfundimit te studimeve.

Neni 4 Programi i Studimit

- a) Programi i Studimit Master Profesional në E Drejtë Biznesi, është program i ciklit të dytë, me kohëzgjatje normale 1 vit dhe me 60 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë.
- b) Programi mësimor është parashikuar të realizohet në 1500 orë, nga të cilat 420 orë janë orë studimi në auditor dhe 1080 janë orë studimi individual.
- c) Procesi mësimor është organizuar në 1 vit akademik, gjatë të cilit studenti fiton 60 kredite (ECTS). Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti kryen praktikë profesionale ose pune ne profilin e tij te studimeve me jo më pak se 5 javë.
- d) Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati Akademik në fillim të çdo viti akademik.

Neni 5 Struktura e programit mësimor

Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 60 kredite, nga të cilat 6 ECTS në kategorinë e lëndëve bazë (A); 24 ECTS në kategorinë e lëndëve karakterizuese të programit (B); 12 ECTS në kategorinë e lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese/profilizuese (C); 6 ECTS në kategorinë e disiplinave e lëndëve plotesuese (D); dhe 12 ECTS në kategorinë e detyrime përmbyllëse (E).

Në tabelën vijuese jepet struktura bazë e programit.

VEPRIMTARITE FORMUESE E PROGRAMIT MASTER PROFESIONAL NË E DREJTË BIZNESI 60 ECTS				
Kategoria	Tipi i komponentit mesimor		Lendet	ECTS
A*	Lëndë Bazë (5-10%) (3-6 ECTS)	1	Zhvillim personal dhe komunikim nderpersonal	6
		2	Shkrim ligjor dhe hartim i kontratave	6
			Total ECTS	6
B**	Lëndët karakterizuese të Programit Master Profesional në EDB (30-40%) (18 -24 ECTS)	1	E drejta e shoqerive tregëtare	6
		2	Gjykimi administrativ	6
		3	E drejta bankare	6
		4	E drejta civile dhe e kontratave	6
		5	E drejta fiskale dhe e krahasuar	6
		6	E drejta administrative e krahasuar	6
		7	E drejte falimenti	6
		8	E drejta e konkurences dhe antitrusti	6
		9	E drejta administrative europiane	6
		10	E drejta pronësore dhe regjimi i pronave	6
		11	E drejta tregëtare europiane	6
		12	E drejte biznesi	6
		13	E drejta e punes	6
		14	E drejta e pronësisë intelektuale	6
		15	Mjedisi rregullator i biznesit	6
		16	Financë dhe kontabilitet për juristët	6
			Total ECTS	24
C***	Lende Nderdisiplinore/	1	Sjellje organizative dhe lidërsip (LZ)	6
		2	Qeverisja e korporatave (LZ)	6

	Integruese/ profilizuese (20-30%) (12 - 18 ECTS)	3	Taksimi i biznesit (LZ)	6
		4	Hyrje në logjikën formale klasike (LZ)	6
		5	E drejta europiane private (LZ)	6
		6	E drejta e mbrojtjes së konsumatorit e krahasuar (LZ)	6
		7	Siguria në biznes dhe shërbimet e sigurisë (LZ)	6
		8	Anglishtja ligjore e biznesit (LZ)	6
D	Lende plotësuese (10%) (6 ECTS)	Total ECTS		12
		1	Praktikë Profesionale	6
E	Detyrime Permbydhese (10-20%) (6 - 12 ECTS)	Total ECTS		6
		1	Raporti i përvijës profesionale	6
		2	Teme Diplome/Provimi i përgjithshëm përfundimtar	6
		Total ECTS		12
Gjithsej 7 Lende		Total ECTS		60
*Lëndët e renditura në këtë grup janë dy lëndë nga ku studenti do të kryej vetëm një lëndë, kjo në varësi edhe të lëndeve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme. Kjo përcaktohet në planet mesimore që përgatiten çdo vit akademik, ku nënsite baze përgjegjëse për këtë program studimi përcaktojnë lëndet që do të ofrohen.				
** Lëndët e renditura në këtë grup janë lende që karakterizojnë programet Master në "E Drejtë Biznesi". Nga të gjitha lëndet e renditura studentet do të bëjnë 4 prej tyre, kjo në varësi edhe të lëndeve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme.				
*** Lëndët e renditura si LZ janë lëndë me zgjedhje, nga të cilat studenti ka të drejtë të zgjedhë vetëm 2 prej tyre.				

Neni 6

Lëndët bazë dhe me zgjedhje

- a) Numri i veprimtarive formuese është 10 ku janë parashikuar 7 lëndë (dhe provime), si edhe praktika profesionale, raporti i përvojës profesionale/projekt menaxhimi, gjithashtu edhe tema e diplomës/provimi i përgjithshëm perfundimtar.
- b) Lëndët janë ndarë në katër grupe kryesore: (A) lëndë baze - 1 lende: (B) lëndë karakterizuese të programit dhe të profilit - 4 lëndë; (C) lëndë nderdisiplinore/integruese - 2 lëndë; (D) praktika profesionale; (E) detyrime permbyllyse, dorezimi dhe mbrojtja e Raportit të Përvojës profesionale/projekt menaxhimit dhe Temës së Diplomës/ Provimi i përgjithshëm perfundimtar.

Neni 7

Plani mësimor

Plani mësimor indikativ pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës disipline dhe veprimtari formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale të ndara në semestra, është dhënë në Aneksin A për këtë programi studimi.

Neni 8

Fleksibiliteti i Strukturës dhe planeve mësimore

Plani mësimor i paraqitur në nenin 7 më sipër, mund të përshtaten çdo vit akademik në përputhje me propozimet e njësive baze dhe aprovohen nga Rektori. Gjithashtu, ky plan mësimor përshtatet edhe në përputhje me nenet 6,7, 12 dhe 32 të Rregullores për Programet Studimit dhe Procesin Mësimor.

Neni 9

Praktikat mësimore

Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit praktik bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e përgjithshme të TBU-së dhe Rregulloren për Praktikën Mësimore.

Neni 10

Kontrolli i dijes dhe sistemi i vleresimit

Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, kontrollin e dijes dhe sistemin e vleresimit janë të përcaktuara me detaje në nenet 14-23 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.

KREU III

PRANIMI I STUDENTËVE DHE AFATET E STUDIMIT

Neni 11

Kriteret dhe Procedura e Pranimit të Studentëve

- a) Programi i studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në E Drejtë Biznesi, është program i hapur për të gjitha ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MAS, si dhe për studentët me transferim.
- b) Përpara fillimit të rregjistrimeve të çdo viti akademik Njesite Baze përgjegjëse për Programin e Studimit përcaktojnë edhe kritere të veçanta të cilat miratohen nga Rektori i TBU.

Neni 12
Afati i studimeve

- a) Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master Profesional në E Drejtë Biznesi është 1 vit akademik.
- b) Në çdo rast studenti nuk mund të zgjasë studimet përtej dyfishit të afatit zyrtar të programit të studimit përveç rasteve kur ai ka pezulluar studimet ashtu si përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme të TBU.

KREU IV
VLERËSIMI ME KREDITE

Neni 13
Kreditet dhe llogaritja e tij

Kreditet për çdo modul përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara nga programi. Në tabelën më poshtë është dhënë ndarja në orë në auditor dhe orë pune individuale, që është përdorur si rregull për çdo një kredit për këtë program studimi.

1 kredit (ECTS) = 25 orë punë në total
Orë në auditor = rreth 10 orë
Orë punë individuale = rreth 15 orë
(Detyra shtëpie, Punë në grup, Provime të pjesshëm, Provimi final)

KREU V
VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT

Neni 14
Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë

- a) Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në E Drejtë Biznesi” vlerësohen çdo vit në përfundim të programit nga Njësia e Brendshme e Vlerësimit të Cilësisë.
- b) Vlerësimi shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij në vite.
- c) Grupi i vlerësimit të brendshëm në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë mbledh të gjithë informacionin për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

- a) Kjo rregullore mund të përsoset e korrigohet në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër programi Master Profesional në E Drejtë Biznesi.
- b) Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit të Drejtësisë dhe Rektori.

Aneks A

PLANI MESIMOR I PROGRAMIT MASTER PROFESIONAL NE E DREJTE BIZNESI, 60 ECTS											
SEMESTRI	Nr.	Lendet	Kategoria e vep.formues e	ECTS	Leksione	Seminare	Jave gjithsej	Gjithsej Leksione	Gjithsej Seminare	Total ore ne auditor	Ore pune individuale
SEMESTRI I	1	Lende baze te programit	A	6	2	2	15	30	30	60	90
	2	Lende karakterizuese e programit nr. 1*	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	3	Lende karakterizuese e programit nr.2 *	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	4	Lende karakterizuese e programit nr.3 *	B	6	2	2	15	30	30	60	90
Total Semestri I*				24	8	8	15	120	120	240	360
SEMESTRI II	1	Lende karakterizuese e programit nr.4 *	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	Lende me Zgjedhje**										
	1	Lende me Zgjedhje nr.1	C	6	2	2	15	30	30	60	90
	2	Lende me Zgjedhje nr.2	C	6	2	2	15	30	30	60	90
	1	Praktike profesionale/ Projekt Menaxhim	D	6							150
	2	Raporti i pervojës profesionale	E	6							150
3	Teme Diplome / Provimi i pergjithshem perfundimtar	E	6							150	
Total Semestri II*				36	6	6	15	90	90	180	720
TOTAL PROGRAMI MASTER PROFESIONAL EDB				60			30	210	210	420	1080
<p>* Lëndët e renditura me këtë emertim do të jenë nga grupi i lëndëve karakterizuese të programit Master Profesional ne E Drejte Biznesi të paraqitur në Tabelen e Veprimtarive Formuese të këtij programi. Nga të gjitha lëndët e renditura studentët do te bëjnë 4 prej tyre, kjo në varësi edhe të lëndëve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme.</p> <p>** Këto lënde do të zgjidhen nga grupi i lëndeve me zgjedhje të këtij program të paraqitura në Tabelen e Veprimtarive Formuese.</p>											